URDHËR
Nr. 6004/1, datë 13.12.2016

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 dhe nenit 7, pika 5, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të nenit 11, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", të nenit 5, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, të nenit 8, pika 3, të udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016, "Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për shqyrtimin, miratimin e nënshkrimin e licencave dhe certifikatave, për shërbimin e rregullt në transportin ndërqytetës të udhëtarëve brenda vendit, zëvendësministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, z. Bahri Shaqiri.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, zëvendësministri i Transportit dhe Infrastrukturës, të zbatojë kriteret e përcaktuara në udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, "Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", në lëshimin e licencave dhe certifikatave.

3. Ngarkohet zëvendësministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Licencimit dhe Rregullave të Ndërtimit, në MTI, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Sokol Dervishaj